




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "NAZMI RUSHITI" PESHKOPI.
Adresa: Lagjia "Nazmi Rushiti" Sheshi "Demokracia" 781021822348E-mail: rrprofesionale@yahoo.com



NJOFTIM

Nr. 02 prot

Peshkopi më: 12.09.2023

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

Drejtuar: DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHITETËSE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, të nenit 12, pika 4 dhe nenit 15, pika 3, të ligjit nr.15 / 2017 datë 16.02.2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2017 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive” si dhe Udhëzimit nr. 14, datë 27.5.2021 “ Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, neni 108, pika 2.

Ofruesi publik i AFP - së - shkolla e mesme profesionale “ Nazmi Rushiti “ Peshkopi, ju njofton krijimin e vendit të lire, me kohë të pjesëshme për 15 orë / javë, për pozicionin – Mësimdhënës profesional, drejtimi :

Hoteleri - Turizëm

Për personelin mësimdhënës të praktikës profesionale,

I – Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithdhme si vijon :

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të llomit, së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masë disiplinore që nuk janë shpallur;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të praktikës profesionale si vijon :

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP - së, për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dosja e aplikimit, e cila përmban:

Dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda datës 22.09.2023.

DIREKTORI

Meleq Alifhasani

